

DITARI MUJOR

PRILL 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

PANAIRI "WORK AND STUDY", MINISTRJA PIRDENI: ADMINISTRATA PORTA HYRËSE PËR TË RINJTË NË TREGUN E PUNËS

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni mori pjesë në Edicionin e 15-të të Panairit "Work&Study". Ministrja Pirdeni ndau me të rinjtë e pranishëm në panair vizionin për energjizimin e administratës ku u ndal tek mundësitë që u ofrohen për të përparuar në karrierën e tyre. Në tendën e DAP-it në panairin "Work & Study", të gjithë të interesuarit morën informacion për DAP-in dhe praktikën e punës, për vendet vakante të disponueshme si dhe patën mundësinë të flasnin më përfaqësues të DAP-it.



MAPA ZHVILLON TRAJNIM PËR PËRDORIMIN E INTELIJENCËS ARTIFICIALE. MINISTRJA PIRDENI: NXISIM SHPEJTËSINË DHE PRODUKTIVITETIN

U zhvillua trajnimi i parë i administratës për përdorimin e Inteligjencës Artificiale gjenerative në punë. Në trajnimin e organizuar nga MAPA me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës (AIE), Ministrja Pirdeni tha se trajnimi i njeh punonjësit e administratës publike me bazat e platformave të AI në punën e përditshme, dhe se është një tjetër hap në funksion të shndërrimit të administratës publike në një ekosistem inovacioni, për të rritur efikasitetin e punës në shërbim të publikut.



MINISTRJA PIRDENI PJESË E VIZITËS HISTORIKE TË DELEGACIONIT TË SHQIPËRISE NË FRANCË ME FTESË TË MACRON

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni ishte pjesë e delegacionit të vizitës historike të Kryeministrit Rama dhe delegacionit të qeverisë shqiptare në Pallatin Elize, me ftesë të Presidentit të Republikës së Francës, Emmanuel Macron. Në Paris u nënshkruan marrëveshje ndërqeveritare me rëndësi, që do të kontribuojnë në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri, përfshirë fushën e praktikave më të mira për zhvillimin e kapitalit njerëzor në administratën publike. Marrëveshja Ndërqeveritare e nivelit të lartë hedh bazat për bashkëpunimin në disa projekte strategjike.



MINISTRJA PIRDENI NGA SAMITI PËR DEMOKRACI NË EVROPËN JUGLINDORE: THEKSI TE REFORMAT SOLIDE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni ishte e ftuar në samitin e 5-të për Demokraci në Evropën Juglindore organizuar nga International Republican Institute me mbështetjen e National Endowment for Democracy në Bruksel. Në fjalën e mbajtur në panelin e organizuar, ministrja Pirdeni vuri theksin tek vazhdimi i reformave solide dhe gjithëpërfshirëse, në drejtim të transformimit dhe konsolidimit të institucioneve demokratike në Shqipëri si dhe avancimit të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.



DITARI MUJOR

PRILL 2024

MINISTRJA PIRDENI TAKIM ME PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS TË RIKTHYER PËRGJATË VITEVE NGA JASHTË

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni takoi një grup profesionistësh të administratës publike dhe kabineteve që janë rikthyer përgjatë viteve nga përvojat studimore apo profesionale jashtë Shqipërisë, për të kontribuar në sektorin publik. Ministrja Pirdeni shpali planin e rienergjitimit për transformimin e mëtejshëm të administratës publike, për të tërhequr gjithnjë e më shumë të rejtat dhe të rinjtë që aktualisht ndodhen si brenda edhe jashtë vendit dhe duan të japin kontributin e tyre për Shqipërinë Evropiane.



MINISTRJA PIRDENI TAKON ZV.KRYEMINISTREN PËR INTEGRIMIN NË BE TË MOLDAVISË, CRISTINA GHERASIMOV

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin priti në një takim zëvendëskryeminstren për Integrimin në Bashkimin Evropian të Moldavisë, Cristina Gherasimov. Ministrja Pirdeni dhe zëvendëskryeminstrija Gherasimov diskutuan në takim mbi bashkëpunimin dypalësh. Gjatë takimit Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Pirdeni ndau eksperiencën e administratës publike të Shqipërisë në përbashkëtimin e fazës së parë të negociatave për anëtarësim.

MINISTRJA PIRDENI ME DHOMAT E TREGTISË DHE BIZNESIT: BASHKËRENDOJMË FORCAT NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

MAPA ka zhvilluar një takim me drejtues dhe përfaqësues të Dhomave të Tregtisë dhe shoqatat e biznesit, për të shkëmbyer praktikën më të mirë në funksion të rritjes së standardit të integritetit dhe luftës antikorrupsion në institucionet shtetërore dhe në sektorin privat. Gjatë fjalës së saj, ministrja Pirdeni bëri të ditur se po punohet intensivisht në hartimin e draftit të strategjisë së re antikorrupsion 2024-2030. Kjo strategji do të ketë një qasje sektoriale me fokus në pesë fusha me interes për biznesin. Diskutimi i hapi rrugën krijimit të një ekipi të përbashkët që do të mbledhet periodikisht për të ndjekur me rigorozitet të gjitha zotimet në kuadër të rritjes së integritetit në sektorin publik dhe privat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN



Ministër i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni